



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2019:168962

Datë: 05.03.2024

Numri i dokumentit: 05411940

Rev.nr.76/2024

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-kolegji i përbërë nga gjyqtarët Beshir Islami, kryetar, Nenad Llaziq dhe Zenel Leku, anëtarë, në çështjen juridike kontestimore të paditësit G. K. nga Gj., të cilin e përfaqëson i autorizuari Isa Salihi, avokat në P., kundër të paditurës “T. A.” nga P., Rruga “...”, pa nr. të cilën e përfaqëson i autorizuari nga Shoqëria e Avokatëve “Kalo Asocietas” përmes avokatëve Gazmend Nushi, Ahmet Hasolli dhe Atdhe Dika, avokat me adresë në P., Rruga “...”, me nr. ..., ... P., me objekt kontesti kompensimin i dëmit me vlerë të kontestit 6,500.00€, duke vendosur lidhur me revizionin e të autorizuarit të paditësit, kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.4428/2020, të datës 06.12.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur më datën 04.03.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si i pabazuar revizioni i të autorizuarit të paditësit, kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.4428/2020, të datës 06.12.2023.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë- Dega në Lipjan, C.nr.245/16, datë 18.11.2019, në pikën I të dispozitivit refuzohet në tërësi kërkesëpadia e paditësit G. K. nga Gj., me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura “T. A.” me seli në P. që paditësit në emër të kompensimit të dëmit jo material, t’ia paguajë shumat si vijon: për frikën e pësuar shumën prej 3,000.00 €; në emër të rehabilitimit psikologjik-psikiatrik shumën prej 400,00 €. Të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8%, duke filluar nga data 02.05.2016, si datë e ndodhjes së aksidentit, e deri në përmbushjen

definitive, si e pabazuar. Ndërsa në pikën II të dispozitivit ka vendosur që secila palë të bartë shpenzimet e veta procedurale.

Gjykata e Apelit të Kosovës, me aktgjykimin Ac.nr.4428/2020, të datës 06.12.2023, ka refuzuar si të pabazuar ankesën e të autorizuarit të paditësit Avokat Isa Salihi nga P., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë- Dega në Lipjan, C.nr.245/16, datën 18.11.2019, është vërtetuar.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, paditësi, përmes të autorizuarit avokat Isa Salihi, nga P., në afat ligjor ka paraqitur revizion, për shkak të aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës të pranoj revizionin, dhe aktgjykimi i Gjykatës Themelore dhe ai Gjykatës se Apelit të ndryshohet, ashtu që kërkesëpadija e paditësit të aprovohet si e bazuar, në shumat e kërkuara në kërkesëpadi.

Gjykata Supreme e Kosovës, në procedurën e vendosjes sipas revizionit në kuptim të dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) nga neni 215, gjeti se:

Revizioni i të autorizuarit të paditësit, është i pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës del se paditësi, ka parashtruar padi, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura, që paditësit në emër të kompensimit të dëmit material dhe jo material t'ia paguaj dhe atë: për dhimbje fizike shumë prej 400.00 €, dhe për frikë shumë prej 500.00 €, me kamatë ligjore, nga dita e paraqitjes së kërkesës te e paditura si dhe t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore. Në procesverbalin e seancës kryesore të datës 18.11.2019, i autorizuari i paditësit pas pranimit të ekspertizës nga lëmi i psikiatrisë, ka bërë precizimin e kërkesëpadisë dhe atë për lartësinë e dëmshpërblimit dhe atë për frikën e përjetuar në shumë prej 3.000.00 €, si dhe shumë prej 400.00 €, sa i përket rehabilitimit psikologjik - psikiatrik. Po ashtu ka kërkuar edhe shpenzimet e krijuar sipas tarifës së OAK, dhe atë për përpilim të padisë, për 3 seancat e mbajtura, për ekspertizën mjeko ligjore si dhe për taksën në padi.

Gjykata e shkallës së parë ka marr aktgjykimin të përshkruar më për së afërmi si në dispozitiv të aktgjykimit të goditur, duke gjetur se në mes palëve ndërgjyqës nuk ishte kontestuese se me datë 02.05.2016, ka ndodhur aksidenti i aeroplanit të k. T. A. në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës Adem Jashari, ku në mbrëmje rreth orës 20:00, gjatë aterimit në pistë aeroplani humb kontrollin dhe shkaktohet aksidenti, por kontestuese në mes palëve ishte pjesëmarrja e paditësit në cilësinë e udhëtarit në aeroplanin e aksidentuar. Gjykata e shkallës së parë në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar nuk ka mundur të provoj se këtu e paditura ka obligim ndaj paditësit që në emër të

kompensimit për frikën e përjetuar, me rastin e rrëshqitjes nga pista të aeroplanit, paditësit t'ia paguaj shumë në emër të frikës së përjetuar si dhe në emër të rehabilitimit psikologjik - psikiatrik.

Gjykata e shkallës së parë në rastin konkret ka gjetur se paditësi nuk i ka ofruar asnjë provë bindëse gjykatës në lidhje me pretendimet e tij se e paditura ka detyrim që paditësit t'ia kompensoj shumat e kërkuara, ngase me asnjë provë konkrete në shkresa të bashkangjitura lëndës nuk ka dëshmuar se ka qenë pasagjer në aeroplanin T. A. të aksidentuar. Gjykata e shkallës së parë duke qenë se paditësi nuk ka ofruar prova të mjaftueshme dhe të besueshme ka vendosur që ta refuzoj kërkesëpadinë e paditësit. Gjykata e shkallës së parë nuk a ka falur besimin provave të bashkangjitur nga paditësi siç janë fotot e bashkangjitura padisë gjykata e shkallës së parë të njëjtat i ka refuzuar si të pa bazuara, nga se të njëjtat nuk dëshmojnë prezencë e paditësit në aeroplan si dhe nuk dëshmojnë në drejtim të vërtetimit të përgjegjësisë së të paditurës, por vetëm dëshmojnë ndodhjen e këtij aksidenti. Vendimin e vet ka bazuar në dispozitën e nenit 136 dhe 154 të LMD-së e lidhur me nenin 143 dhe 7.1 të LPK-së.

Gjykata e Apelit e Kosovës, ka gjetur se aktgjykimi i goditur nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të procedurës kontestimore, në të cilat kjo gjykatë shikon sipas detyrës zyrtare, e as në ato në të cilat thirret ankesa nga neni 182 par. 2 pika n) të LPK-së. Kjo për faktin se aktgjykimi i goditur nuk ka të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet, përkatësisht është e qartë. Dispozitivi i aktgjykimit nuk është kontradiktor me vetveten e as me arsyet e aktgjykimit. Në aktgjykim janë dhënë arsye, përkatësisht janë treguar arsytet për faktet vendimtare për një vendim të drejtë e të ligjshëm, e të cilat arsye i pranon edhe kjo gjykatë në tërësi.

Gjykata e Apelit e Kosovës ka vlerësuar se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vërtetuar se paditësi nuk i ka ofruar provë bindëse në lidhje me pretendimin e tij se e paditura ka detyrim që paditësit t'ia kompensoj dëmin për frikë dhe shërimin psikologjik - psikiatrik, e posaçërisht në drejtim të provuarit se ishte pasagjer në aeroplanin e k. T. A. të aksidentuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga një gjendje e tillë e çështjes, pranon si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e gjykatës së shkallës së parë dhe të gjykatës së shkallës së dytë lidhur me refuzimin e kërkesëpadisë së paditësit, pasi që aktgjykimet e instancave më të ulëta nuk janë të përfshira në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe as në zbatim të gabuar të së drejtës materiale.

Pretendimet për shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika n) të LPK-së, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës nuk janë të themelta. Kjo për shkak se gjykatat e instancave më të ulëta i janë përmbajtur në tërësi kërkesave të LPK-së, për strukturën dhe përmbajtjen e aktgjykimit. Në aktgjykimin e shkallës së parë dispozitivi është i rregullt dhe në përputhje të plotë me arsyetimin e dhënë, ndërsa aktgjykimi i shkallës së dytë përmban arsye të mjaftueshme dhe bindëse për të gjitha pretendimet e paraqitura në ankesë, përfshirë edhe shkeljet që shikohen sipas detyrës zyrtare. Gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të mjaftueshme dhe bindëse lidhur me mënyrën e vendosjes meritore të çështjes kontestuese. Në këtë kontekst, janë dhënë arsye bindëse me të cilat janë treguar faktet thelbësore të cilat janë marrë në vlerësim me rastin e vendosjes meritore, janë dhënë arsye për mënyrën e vërtetimit të fakteve, për provat e shfrytëzuara dhe për mënyrën e vlerësimit të provave të shfrytëzuara.

Në logjikën e njëjtë është edhe aktgjykimi i shkallës së dytë në të cilin paraqiten arsyet për konfirmimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë ka përmbajtje koherente në rrjedhë logjike dhe juridike duke i arsyetuar të gjitha pretendimet ankimore dhe shkeljet që vlerësohen sipas detyrës zyrtare, lidhur me vlerësimin se aktgjykimi i shkallës së parë është i ligjshëm.

Në këtë kontekst me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë janë konsumuar të gjitha pretendimet ankimore përmes vlerësimit objektiv dhe në përputhje me dispozita ligjore, prandaj Gjykata Supreme e Kosovës e vlerëson të paqëndrueshëm pretendimin për shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore lidhur me strukturën dhe përmbajtjen e aktgjyqimeve të instancave më të ulëta.

Pala paditëse në fazën e ankesës e kishte paraqitur një kopje të një bilete e cila nuk kishte as emër të paditësit. Gjykata Supreme e Kosovës e aprovon qëndrimin e Gjykatës së Apelit kur vlerësoj provën e bashkangjitur ankesës dhe gjeti se në kuptim të nenit 180.1 të LPK-së, në ankesë nuk mund të paraqiten faktet të reja dhe të propozohen prova të reja përveç se kur ankuesi jep prova se pa fajin e vet nuk ka mundur ti paraqes përkatësisht ti propozoj gjer në përfundimin e shqyrtimit kryesor në gjykatën e shkallës së parë. Prova e re e prezantuar në ankesë është provë përkatësisht fakt që ka ekzistuar para përfundimit të procedurës para gjykatës së shkallës së parë, por të cilat nuk janë paraqitur nga pala gjegjësisht paditësi dhe tani më me dispozitën e lartcekur ligjore paditësi nuk mund të paraqes fakte dhe as prova të reja në procedurën para gjykatës sipas ankesës dhe gjykata

sipas ankesës duhet të marr për bazë gjendjen faktike të konstatuar në përfundim të procedurës para gjykatës së shkallës së parë.

Kjo aq më tepër kur paditësi nuk ka mundur të provoj se këtë provë pa fajin e tij nuk ka mundur të paraqet përkatësisht të përdorë në procedurën para gjykatës së shkallës së parë. Prandaj, kjo gjykatë gjen se gjykata e shkallës së parë pran gjendjes faktike të vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, duke zbatuar drejtë të drejtën materiale, drejtë ka refuzuar kërkesëpadinë paditësit.

Thëniet e paditësit në revizion se aktgjykimi i atakuar është marrë me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale, kjo Gjykatë i vlerësoi si të pabazuara, ngase, gjykata e revizionit vlerëson se në rastin konkret, kemi të bëjmë me kompensimin e dëmit ku nuk është përcaktuar se a ekziston përgjegjësia për dëmin e shkaktuar nga sendet apo veprimtaria e rrezikshme, dhe se a ekziston edhe lidhja kauzale midis efektit të sendit apo veprimtarisë së rrezikshme dhe pasojës së dëmit, ndërsa në revizionin e të paditurës në përgjithësi janë përsëritur thëniet e paraqitura në ankesën kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, për refuzimin e të cilave gjykata e shkallës së dytë ka dhënë arsye të duhura, bindëse dhe të mjaftueshme, e të pranueshme edhe për gjykatën e revizionit. Incidenti ka ndodhur më 02.05.2016, padia është paraqitur më 03.06.2016 kurse raporti i mjekut për kontroll shëndetësorë është i datës 03.06.2016 dhe me asnjë provë nuk është mbështetur fakti se me cilën kompani ka fluturuar, me biletë të nominuar në emër të tij e as që ka ndonjë raport të Autoritetit të Operimit në Aviacionin Civil, i cili do të dëshmonte ndodhjen e incidentit dhe shkaktimin e dëmit.

Vlerësimi i Gjykatës së Apelit se pala paditëse nuk i ka dëshmuar pretendimet, e që ka pas obligim duke u bazuar edhe në nenin 322, paragrafi 2, të LPK-së në të cilin është parashikuar që: “Pala që pretendon se i takon një e drejtë ka për detyrë të provojë faktin që është qenësor për krijimin ose realizimin e saj, po që se ligji nuk parasheh diç tjetër” është aprovuar edhe nga gjykata e Revizionit

Në revizion, përsëriten thëniet përkitazi me gjendjen faktike, të cilat gjykatat e instancës më të ulët, i kanë vlerësuar dhe për të gjitha këto kanë dhënë arsye në arsyetimin e aktgjykimit. Për më tepër kjo gjykatë shton, se sipas nenit 214.2 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, revizioni nuk mund të paraqitet për shkak të konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike, përderisa revizioni në të vërtetë, për këtë arsye i godet aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët.

Nga sa u tha më sipër e me zbatimin e nenit 222 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË

Rev.nr.76/2024, datë 04.03.2024

Kryetari i kolegjit,

Beshir Islami